



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:024603

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05743799

P.nr.47/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshem, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Ismajl Kuçi, në lëndën penale ndaj të pandehurit G.G nga fsh....-Drenas, i akuzuar për veprën penale,Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj: PP.II.nr.143/21 te dt.18.02.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 23.05.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit, Besnik Nuredini dhe të pandehurit, me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare, av. N. R., dhe në mungesë të përfaqësuesit të dëmtuarës, me dt.27.05.2024 mori dhe shpalli, dhe të njejtën datë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri G.G me nofken ..., nga fshati ..., Komuna Drenas , me adrese banimi ne Rr. “ ...”, i lindur më dt. .. ne Skënderaj , nga i ati A...dhe e ema V..., e gjinisë K...i , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr .personal:...

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 03.12.2020, rreth orës 12:30, në rrugën “Ismail Raka”, Kaçanik, saktësisht në Xhaminë e Qytetit “Koxha Sinan Pasha”, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete, nga ndërtesa fetare kishte marrë një sasi të parave që ishin grumbulluar për mirëmbajtjen e xhamisë, ashtu që fillimisht kishte qëndruar në xhami me pretekstin për të takuar ..., dhe pastaj duke përdorur forcën me anë të një mjeti të fortë kishte thyer arkën dhe nga aty kishte marrë rreth 100.00 €,-

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 2 nënpar 2.2 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,42,69,70,71 par.1.3 dhe 72 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-se, si dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me dënim burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, I cili do të ekzekutohet pas plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 20.00€, kurse për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës, B. D. nga Kaçaniku, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në contest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzen PP.II.nr.143/21 të dt.18.02.2021, të pandehurin G.G nga fshati ..., Komuna Drenas, e ka akuzuar për veprën penale, Vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 2 nënpar 2.2 të KPRK-së.

Në bazë të kesaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me dt. 23.05.2024.

Prokurori I shtetit Besnik Nuredini, në fjalën e tij me rastin e prezentimit të aktakuzës, deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar me shkrim pranë kesaj gjykate.

I pandehuri, në fjalën e tij, pas prezentimit të aktakuzës, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, duke shtuar se, pas fillimit të vuajtjes së dënimit me burgim, i njëjti e ka kuptuar gabimin e tij për të gjitha rastet, por që i premtonte gjykatës se pas përfundimit të vuajtjes së dënimit me burgim, nuk do të përsërisë më këso veprime, prandaj edhe i kërkonte gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit, lidhur me këtë çështje penale, t'i shqiptohet një dënim sa më i ulët që të jetë e mundur.

Prokurori I shtetit dhe mbrojtësi sipas detyrës zyrtare, në fjalën e tyre janë dakorduar me pranimin e fajësive nga ana e të pandehurit.

Përfaqësuesi I të dëmtuarës, nuk ka qenë prezent në shqyrtim gjyqësor.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 1 të KPRK-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësive është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me këtë gjykata vertetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e aktakuzës.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 2 nënpar 2.2 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në tërësi në shqyrtimin fillestar, ndihet i penduar për veprimet e tij, i premtonte gjykatës se në të ardhmen, gjegjësisht pasi të përfundojë dënimin me burgim, nuk do të përsërisë veprime të tilla, mosha e tij e re në kohën e kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti se i njëjti, bazuar në evidencën penale raporti i së cilës i është

bashkangjitur shkresave të lëndës, ka patur edhe raste të tjera penale, kryesisht për veprën penale vjedhje e rëndë, për të cilat është shpallur fajtor me vendime të plotfuqishme, ndërsa rrethanë tjetër rënduese për të pandehurin nuk gjeti, përveq veprimeve të tij, të cilat paraqesin elemente të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin G.G, i akuzuar për veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 2 nënpar 2.2 të KPRK-së, e gjykoji me dënim si ne dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është ne proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë, që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet ne tërësi qëllimi i dënimit i paraparë ne nenin 38 te KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 te Ligjit për Kompensimin e Viktimave te Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore jurididike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.47/21 datë 27.05.2024

Bashkpunëtori profesional
Ismajl Kuçi

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.